



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNËS - SHITIME
Komiteti për Politikë dhe Financa
Nr.01-060/01-4242/20 datë: 18.02.2020



Npi – 01/63 datë: 24.02.2020

Duke u bazuar në nenin 49 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, si dhe në bazë të nenit 3.11 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/149 datë: 31.05.2019, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më: 24.02.2020 nxjerr këtë:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË -II- TË KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

E mbajtur më datën: 24.02.2020 (e hënë) në ora 10.00 h. në sallën Nr.1 të Kuvendit

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesja znj.Medina Brahaj, pastaj anëtarët e Komitetit z.Perparim Ramusa, znj.Arbresha Sylja, z.Naim Zejna, znj.Zarife Rexhaj, z.Ruzhdi Jashari, dhe znj.Adelina Beqaj. Përveç anëtarëve të KPF-së në mbledhje kanë marrë pjesë edhe: Nënkryetari, z.Rahman Jakupi; Drejtorët, znj.Hava Qarri dhe z.Halil Halili; Zyrtarja Kryesore Financiare, znj.Ardita Ndrecaj; Zyrtari për barazi gjinore z.Reshat Gashi; Zyrtari për Informim z.Lulzim Sahiti; Zyrtari i IT-së z.Gazmend Ademaj. Mbledhjen e hapi, Kryesuesja e KPF-së znj.Medina Brahaj, e cila pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes. Për këtë mbledhje është propozuar ky:

REND DITE

1. Shqyrtimi i ekstrakt procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 19.12.2019, dhe 28.01.2020.
2. Rishqyrtimi i Ligjshmërisë të Rregullores Komunale për Taksa, tarifa dhe Gjoha sipas MAPL-së,
3. Draft-Programi Komunal për banim për periudhën 2020-2022,
4. Raport periodik për zbatimin e rekomandimeve,
5. Lista e kërkesave,
6. **Propozim-Plani i Punës së KKS-së për vitin 2020. (Pikë Shtesë)**

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Para se të hapë diskutimin për rendin e ditës, fjalën ja dha Nënkryetarit, z.Rahman Jakupi, lidhur me kërkesën për të propozuar edhe një pikë shtesë.

Nënkryetari, z.Rahman Jakupi; Përshëndetje, para se të procedohet me rendin e ditës unë e propozoi që të futet edhe një pikë shtesë e rendit të ditës, Propozim-Plani i Punës së KKS-së për vitin 2020. Dokumenti për këtë pikë është përgatitur në formë të shkruar dhe e keni marrë, arsyeja pse po e propozojmë si pikë shtesë është se realisht ne jemi vonuar për dy muaj për miratimin e këtij plani. Ne po duam që ta fusim në rendin e ditës edhe për faktin se ky dokument duhet të shkojë në diskutim publik dhe edhe aty do të na merr pak kohë. Ju ftoj që ta votoni futjen e kësaj pike shtesë në rendin e ditës.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Hapi diskutimin për rendin e ditës.

z.Perparim Ramusa; Përshëndetje, pajtohem me pikat e rendit të ditës, edhe me pikën shtesë të propozuar nga Nënkryetari, që të shkojë në diskutim publik.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Konstatoi kuorumin prej 6 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht aprovoi rendin e ditës, me pikën e 6 shtesë, Propozim-Plani i Punës së KKSBB-së për vitin 2020, të propozuar nga Nënkryetari.**

Pika 1

Shqyrtimi i ekstrakt procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 19.12.2019, dhe 28.01.2020
Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Hapi diskutimin për këtë pikë. Meqenëse diskutime nuk kishte Kryesuesja e KPF-së Konstatoi kuorumin prej 6 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht, aprovoi të dy ekstrakt procesverbalet nga mbledhjet e mbajtura, më 19.12.2019 dhe 28.01.2020.**

Pika 2

Rishqyrtimi i Ligjshmërisë të Rregullores Komunale për Taksa, tarifa dhe Gjoha sipas MAPL-së
Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Fjalën për prezantimin e kësaj pike ja dha Ardita Ndrecaj.

znj.Ardita Ndrecaj, zyrtare kryesore financiare; Pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, e prezantoi këtë pikë në pikat kryesore. Ajo tha se dokumentin tani më e keni marrë dhe e keni lexuar, nëse ka ndonjë pyetje unë jam gati tu përgjigjem. (shih dokumentin)

z.Naim Zejna; Përshëndetje, ne e kemi pritë që në dukje të shohim cilat janë ndryshimet që duhet të bëhen, sepse siq e dini ne e kemi ndryshuar një herë këtë rregullore, tash lind pyetja se ku është faji që e ka kthyer Ministria për rishqyrtim, a është faji te Zyrtari Ligjor apo te Ministria. Unë po kërkoj që kjo të evidentohet si vërejtje për ekzekutivin që propozimet të përgatiten mirë, sidomos sa i përket bazës ligjore, dhe ne pastaj mos të marrim vendime të cilat po i kthen MAPL-ja.

z.Perparim Ramusa; Sa i përket kësaj pike unë kërkoj që të procedohet me ndryshimet e nevojshme në Ministrinë e Linjës. Ne nuk jemi këtu duke e luajtë rolin e prokurorisë. Ne si Komitet dhe Kuvend kemi marrë vendimet ashtu si është kërkuar.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Konstatoi kuorumin prej 6 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi t'i rekomandoj Kuvendit aprovimin e ndryshimeve në Rregulloren Komunale për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2020, sipas kërkesës të MAPL-së.**

Pika 3

Draft-Programi Komunal për banim për periudhën 2020-2022

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Para se të hapë diskutimin për këtë pikë tha: Ky Draft-Program Komunal për banim për periudhën 2020-2022, duhet të shkojë në diskutim publik, në vazhdim po hapi diskutimin për këtë pikë.

znj.Zarife Rexhaj; Përshëndetje, sa e pashë unë ky Draft-Program është veqse një përshkrim i gjendjes ekzistuese e jo ndonjë program që ofron ndonjë zgjidhje të nevojave për banim. Realisht unë nuk po e kuptoj se cila ka qenë nevoja për një program të tillë për banim.

znj.Adalina Beqaj; Përshëndetje, unë mendoj se me këtë program është hartuar një plan i cili ofron mundësi më të mëdha për sa i përket banimit dhe strehimit të personave ose familjeve në nevojë. Unë kam kërkuar që kësaj kategorie për banim ti shtohen edhe nënat vetëushqyese.

z.Ruzhdi Jashari; Përshëndetje, sa i përket kësaj pike ne nuk kemi marrë material për të diskutuar.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Sqaroi se materialin për këtë pikë e keni marrë, me E-mail, por materiali është i përbashkët me materialet tjera së bashku me Ftesën për mbledhje të Kuvendit. Në vazhdim Kryesuesja e KPF-së, Konstatoi kuorumin prej 6 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht i Rekomandon Kuvendit aprovimin e vendimit për ta nxjerrë në diskutim publik për 15 ditë, Draft-Programin Komunal për banim për periudhën 2020-2022.**

Pika 4

Raport periodik për zbatimin e rekomandimeve të Auditorit të përgjithshëm

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Fjalën për prezantimin e kësaj pike ja dha Ardita Ndrecaj.

znj. Ardita Ndrecaj, zyrtare kryesore financiare; Prezantoi këtë pikë në vija të trasha. Meqenëse dokumentin për këtë pikë e keni marrë në formë të shkruar unë nuk do ta zgjati më shumë, por i mirëpres pyetjet e juaja. (shih dokumentin)

z. Naim Zejna; Cili është ai rekomandim që nuk është zbatuar, kërkoj që këtë pyetje ta merrni në shënim dhe ta përgatitni për mbledhjen e Kuvendit.

znj. Ardita Ndrecaj, zyrtare kryesore financiare; (nuk është dëgjuar diskutimi).

z. Ruzhdi Jashari; Kur po flitet për qështjen e pagesave, a është fjala këtu për Komunën a është fjala për Ministrinë?

znj. Ardita Ndrecaj, zyrtare kryesore financiare; Këtu po bëhet fjalë për Komunën.

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Konstatoi kuorumin prej 6 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, me 4 vota "Për" dhe me 2 vota "Abstenim" vendosi t'i rekomandoj Kuvendit aprovimin e Raportit Periodik për zbatimin e Rekomandimeve të Auditorit të përgjithshëm.**

Pika 5

Shqyrtimi i Kërkesave

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Lexoi kërkesat:

1. Kërkesa e z. Arsim Hajrizi, nga Shtimja, i cili në emër të 17 familjeve që jetojnë në segmentin e Rrugës "Adem Jashari" ka kërkuar nga Kuvendi i Komunës së Shtimes që kjo pjesë e rrugës "Adem Jashari" në drejtimin Shtime-Lipjan, të emërtohet me një emër, sepse nuk ka as emër e as numra të shtëpive.

Pastaj Kryesuesja lexoi Rekomandimin e DPUKGJ-së, dhe në vazhdim hapi diskutimin për këtë kërkesë.

z. Perparim Ramusa; Meqenëse kjo kërkesë nuk është kompetencë e jona unë propozoj që Komiteti për Politikë dhe Financa ti rekomandoj Kuvendit që kërkesën e Arsim Hajrizit ta transferojë në Drejtorinë për Planifikim Urban, Kadster dhe Gjeodezi.

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Konstatoi kuorumin prej 6 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, me 5 vota "Për" dhe me 1 votë "Abstenim" vendosi t'i rekomandoj Kuvendit, që kërkesa e z. Arsim Hajrizit nga Shtimja, me numër Nr.01-070/05-2666/20 datë:30.01.2020 të transferohet te Drejtoria për Planifikim, Urban, Kadaster dhe Geodezi që të shqyrtohet sipas Udhëzimit Administrativ Nr.14/2019 dhe Udhëzimit Administrativ 17/2019 të cilat e rregullojnë procedurën e emërtimit dhe numërtimit të rrugëve.**

2. Kërkesa e z. Bahri Rexhaj nga fshati Petrovë, i përfaqësuar nga Avokati z. Kemajl Ademaj, Kërkesa Nr.01-070/05-1225/20 datë:16.01.2020, i cili në emër të z. Bahri Rexhaj nga fshati Petrovë, ka kërkuar nga Kuvendi i Komunës së Shtimes, këmbimin e pronës së pa luajtshme që i është marrë nga Komuna me rastin e hapjes së rrugës Petrovë-Llanisht, në pjesë të Ngatrës Kadastrale Nr.985-2 Z.K-Petrovë, vendi i quajtur "Arat e Hoxhës" me sipërfaqe prej 699 m², si dhe pjesë të Ngatrës Kadastrale Nr.118-2 Z.K-Petrovë, vendi i quajtur "Rrahishtë" me sipërfaqe prej 154 m².

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Lexoi Rekomandimin e Zyrtarit Ligjor, dhe në vazhdim hapi diskutimin për këtë kërkesë.

znj. Zarife Rexhaj; Nëse pala është pajtuar për me bërë këmbimin e pronës, atëherë unë e përkrahu këtë kërkesë.

z. Naim Zejna; Te kjo kërkesë kemi një procedurë të filluar Gjyqësore e cila ka ndaluar për ti dhënë shansë Kuvendit për me e zgjidhë këtë qështje, mirëpo kjo procedurë ka një kosto të cilën duhet ta bartim ne. Unë e përkrahu këtë propozim për ndrrimin e tokës.

z.Perparim Ramusa; E kuptova aspektin ligjor, mirëpo unë jam që te kjo kërkesë mos të ngutemi, ta analizojmë mirë e mirë, që mos të kemi problem sikur te prona që është ndrruar Lagja e Pajtimit - Davidovc. Unë jam që kjo kërkesë të shtyhet.

z.Ruzhdi Jashari; Është shumë e rëndësishme që të veprohet me të njëjtin kuti te secili rast i njejt. Këto qështje të këmbimit të pronave vazhdimisht po na sjellin probleme. Në fillim palës ja marrin tokën e pastaj e binë në Kuvend dhe thonë qka me bërë. Unë jam për me shikuar mundësinë që palën me e kompenzuar.

z.Lulzim Muharremi, zyrtar ligjor; Gjykata do ta bëj shpronësimin e tokës deshëm apo nuk deshëm ne, sipas ekspertit të tyre. Nëse ka mjete financiare normalisht mund të shkohet edhe me shpronësim, nga Komuna. Ai ka zënë tokë komunale, ne si Komunë ja kemi marrë një pjesë të tokës për rrugë, kështu që pala ka kërkuar këmbimin e tokave. Shpenzimet gjyqësore mbeten në kompetencë të Gjykatës që të vendosë se kush duhet ti paguaj.

z.Perparim Ramusa; Unë po propozoj që kjo pikë të shtyhet sepse nuk është shumë urgjente. Konsideroj se duhet ta analizojmë më mirë sepse mos po na del problem më shumë.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj: Konstatoi kuorumin prej 6 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, me 4 vota “Për” dhe me 2 vota “Kundër” vendosi t’i rekomandoj Kuvendit, që kërkesa e z.Bahri Rexhaj nga fshati Petrovë, me numër Nr.01-070/05-1225/20 datë:16.01.2020, të aprovet sipas rekomandimit të Zyrtarit Ligjor, si vijon:** Në bazë të ligjit nr.06/L-092 Për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Komuna ka të drejtë të këmbjë pronën e paluajtshme të komunës me persona fizik dhe juridik neni 24 i këtij ligji dhe sipas nenin 25 edhe personat fizik dhe juridik mund të bëjnë kërkesë për këmbimin e pronës së tyre me pronën e komunës. Në të dy rastet këmbimi i pronës së paluajtshme të komunës bëhet vetëm për sigurimin e pronës për qëllime të përmbushjes së interesit publik.

Pas verifikimit të pronave, të cilat janë propozuar për këmbim dhe sqarimeve të nevojshme nga drejtoria përkatëse, gjithnjë duke u bazuar në ligjin e cekur më lartë, nëse këto prona do të përmbushnin kushtin sipas ligjit, *qëllimit të përmbushjes së interesit publik*, këmbimi do të bënte një zgjidhje të këtij kontesti, pa kosto financiare për komunën. Në të kundërtën nëse shkohet në shpronësim, vlera e shpronësimit e konstatuar nga eksperti gjyqësor, duke ia shtuar edhe shpenzimet procedurës gjyqësore, do të kalonte mbi 25,000.00 € dhe prona tjetër të cilën e propozon për këmbim Bahri Rexhaj, do të mbetej barrë e organeve të komunës në ardhmen, si një kontest i pa zgjidhur.

Pika 6 (Pikë shtesë)

Propozim-Plani i Punës së KKSB-së për vitin 2020


Kryesuesja, znj.Medina Brahaj: Hapi diskutimin për këtë pikë.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj: Konstatoi kuorumin prej 6 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht i Rekomandon Kuvendit aprovimin e vendimit për ta nxjerrë në diskutim publik për 15 ditë, Propozim-Planin e Punës së KKSB-së për vitin 2020.**

Pasi që diskutime tjera nuk kishte, Kryesuesja, mbledhjen e përfundoi ne ora 10.49h.

Procesmbajtësi:
Idajet Rexhepi



Kryesuesja e KPF
Medina Brahaj

